



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2025

PLANI I PUNËS

2025

OBJEKTIVAT KRYESORE DHE PRITSHMËRITË
DREJTIMET DHE MËNYRAT E REALIZIMIT

PËRMBAJTJA

1) HYRJE.

2) OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025.

3) DREJTIMET KRYESORE DHE MËNYRAT E REALIZIMIT.

4) PROJEKTET E KSHK.

5) PARASHIKIMI BUXHETOR 2025 ME ZËRAT PËRKATËS.

1) HYRJE

Plani Vjetor i Punës i Komitetit Shtetëror për Kultet për vitin 2025 hartohet bazuar në detyrat institucionale të përcaktuara në VKM nr. 459, datë 23.09.1999, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, i ndryshuar, në përvojën shumëvjeçare të tij, në Planin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, ligjin 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, në strukturën organizative dhe burimet financiare të Komitetit Shtetëror për Kultet, në strategjitë ndërsektoriale, në pritshmëritë që qeveria dhe situata kombëtare dhe ndërkombëtare parashtrojnë lidhur me çështjet fetare. Po ashtu, dinamikat dhe faktorët e ndryshëm që ndikojnë në trajtimin e çështjeve me ndjeshmëri dhe pjekuri, rezultatet e arritura gjatë vitit të kaluar dhe rekomandimet e evidentuara nga analiza vjetore e aktivitetit institucional përgjatë vitit 2024, diktojnë përpilimin e planit të mëposhtëm të KSHK.

2) OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

Komiteti Shtetëror për Kultet zbaton politikën shtetërore në fushën e marrëdhënieve ndërmjet Shtetit dhe bashkësive fetare në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe shoqatat, organizatat, fondacionet me karakter humanitaro-fetar, duke krijuar kushtet ligjore e financiare për të përmirësuar cilësisht këto marrëdhënie. Ky institucion, duke iu përmbajtur legjislacionit në fuqi për mbështetjen financiare të bashkësive fetare, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me shtetin bën kalimin e fondit për përmirësimin e infrastrukturës së tyre administrative, arsimore, shpirtërore e kulturore, si faktorë bazë që ndihmojnë në rritjen e pavarësisë së tyre ekonomike, ruajtjen e traditës, harmonisë dhe tolerancës fetare në vend.

Nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet shtetërore, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për fenë, Komiteti Shtetëror për Kultet mbështet direkt bashkësitë fetare në veprimtari të mirëfillta fetare, në zgjidhjen e çështjes së pronave të tyre, në çështje të arsimimit fetar, në promovimin e vlerave kulturore fetare në vend e në diasporë, duke ruajtur laicitetin dhe asnjësinë e shtetit në raport me bashkësitë dhe shoqatat fetare, si dhe barazinë e tyre para ligjit. Për këtë qëllim, garantimi i një mjedisi ku çdo bashkësi fetare të shprehë dhe praktikojë lirisht besimin e vet, si dhe trajtimi dhe kthimi i aseteve të mundshme bashkësive fetare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është një prioritet i Komitetit Shtetëror për Kultet. Njëkohësisht, duke konsideruar BF dhe shoqatat fetare si pjesë aktive e shoqërisë dhe partnere të shtetit në zgjidhjen e plagëve të ndryshme sociale, gjatë vitit 2025 do të intensifikohet ndikimi i KSHK-së në forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese mes tyre dhe pushtetit qendror e vendor.

3) DREJTIMET KRYESORE DHE MËNYRAT E REALIZIMIT

Si për çdo institucion të administratës shtetërore, funksionimi i Komitetit Shtetëror për Kultet bëhet në bazë të direktivave dhe strategjive qeveritare. Duke patur parasysh natyrën e veçantë të punës që lidhet me anën shpirtërore të besimtarëve dhe sfidat me të cilat përballlet shoqëria e

sotme shqiptare dhe jo vetëm, më poshtë paraqiten drejtimit ku duhet të fokusohet vëmendja e institucionit.

Zbatueshmëria ligjore e Marrëveshjeve

Gjatë vitit 2025 do të vijojë puna për zbatimin e Marrëveshjeve, të cilat janë të pasqyruara në Ligjin Nr. 8902, datë 23.05.2002 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, Ligjin Nr. 10056, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, Ligjin Nr. 10057, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, Ligjin Nr. 10058, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshit Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella” dhe Ligjin nr. 10394, datë 10.03.2011 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

Shteti shqiptar është garantues i së drejtës së lirisë së besimit fetar dhe për këtë qëllim krijon kushtet për përmbushjen e kësaj të drejte. Zbatimi i ligjit nr. 10140, datë 15.05.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, bëhet nëpërmjet përgatitjes së aktit nënligjor për këtë qëllim.

Gjatë vitit 2025 do të vijojnë përpjekjet e KSHK-së për t’i ardhur në ndihmë zgjidhjes së procesit të kthimit të pronave bashkësive fetare, në bashkëpunim të plotë me institucionet përkatëse. Në këtë drejtim, aktualisht është duke u punuar me kërkesat e Kishës Katolike në Shqipëri për trajtimin dhe kompensimin e pronave e saj, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 142, datë 01.08.2024, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Pjesëmarrjen në Komisionin e Përbashkët *Ad-Hoc* për Zgjidhjen e Çështjes së Trajtimit të Pronave (kthimit dhe kompensimit) të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces, që ka nisur në shtator 2024, do vijojë edhe përgjatë vitit 2025.

Forcimi i marrëdhënieve me bashkësitë fetare dhe zgjidhja e problematikave të tyre

Ky objektivi që përbën një nga shtyllat për përmbushjen e rolit institucional, duhet të realizohet nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm me BF, intensifikimit të përpjekjeve për njohjen nga afër të problematikave të tyre, shtimit të iniciativës në zgjidhjen e shpejtë të sa më sipër. Për këtë qëllim, do të parashikohen të paktën dy takime mujore me secilën bashkësi fetare, pra, takime me krerët lokalë fetarë, me pushtetin vendor dhe vizita nëpër shkollat e bashkësive fetare (rreth 150 të tilla). Mbështetja e KSHK-së për nismat që promovojnë dialogun dhe bashkëjetesën ndërfetare do të jetë e gjithanshme. Nuk do të lihen mënjana aktivitetet e organizuara nga bashkësitë, ku do

të sigurohet pjesëmarrja dhe kontributi i përfaqësuesve të KSHK-së. Sigurisht, planet e punës mujore, të hartuara e miratuara paraprakisht, do të jenë udhëzues veprimi.

Gjatë vitit 2025, duhet fokusuar puna në dhënien jetë të projekteve të përbashkëta për trajtimin e çështjeve me rëndësi për shoqërinë shqiptare, si projektet me karakter promovues të shembullit tradicional të bashkëjetesës fetare në Shqipëri dhe jashtë saj dhe projektet me karakter nxitjen dhe forcimin e dialogut mes shtetit dhe feve, drejtuar jo vetëm bashkësive fetare, por edhe shoqatave të ndryshme me karakter humanitaro-fetar që operojnë në vend, në nivel qendror dhe lokal.

Thellimi i bashkëpunimit me institucionet shtetërore që lidhen me çështjet fetare

Gjatë vitit 2025, pozicioni i KSHK-së, në raport me institucionet shtetërore që trajtojnë çështje të lidhura me bashkësitë apo shoqatat fetare, duhet ngritur në një nivel akoma më cilësor dhe të rëndësishëm. Për këtë qëllim duhen intensifikuar takimet, informacionet e dhëna e të marra, propozimet për projekte të përbashkëta, të forcohet vijueshmëria dhe mbikëqyrja e zgjidhjes së problematikave shqetësuese, etj.

Gjatë vitit 2025, është menduar që të ndiqen në terren objektet e kultit monument kulture, nisur dhe në zbatim të një prej detyrave themelore të KSHK-së, që është interesimi për ruajtjen e vlerave të këtyre objekteve.

Raportet me MASR, MPEJ, ASHK, Pushtetin Vendor, etj. duhen thelluar më tej, në shërbim dhe funksion të rolit ligjor institucional, si dhe duhet insistuar në zgjidhjen përfundimtare të çështjeve përkatëse.

Ngritja dhe promovimi i pozicionit të KSHK-së në shkallë rajonale dhe botërore

Viti 2025 do të vijojë me organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete e udhëtime jashtë vendit. Për këtë qëllim, ky objektivi do të arrihet nëpërmjet:

- Promovimit institucional të KSHK-së, në takimet zyrtare që duhet të zhvillohen me përfaqësuesit diplomatikë të vendeve të huaja në Republikën e Shqipërisë.
- Pjesëmarrjes aktive në uorkshope, konferenca, simpoziume etj, në shkallë rajonale dhe ndërkombëtare, ku të paraqiten saktë dhe qartë, roli, puna dhe arritjet e institucionit.
- Përgatitjes së raportimeve ndërkombëtare lidhur me çështjen e lirisë së besimit dhe fesë në Shqipëri.
- Shkëmbimeve të vazhdueshme me diasporën shqiptare nëpër botë, jo vetëm në formë korrespondence, por edhe nëpërmjet takimeve direkte.
- Fuqizimit të shkëmbimeve të eksperiencës me homologët e KSHK-së në botë, sidomos në vende me ngjashmëri të kuadrit të larmishëm fetar dhe me përvojë të konsoliduar në çështjet e fesë.

4) PROJEKTET E KSHK

Duke patur parasysh panoramën fetare në vend dhe duke i konsideruar BF dhe Shoqatat me karakter fetar si partnerë në zgjidhjen e plagëve sociale, KSHK parashikon për vitin 2025:

- Vijimin e netuorkut rajonal të bashkëpunimit mes homologëve, për shkëmbim eksperiencash, promovim vlerash të bashkëjetesës fetare, rritje të sigurisë rajonale.
- Përgatitjen e një projekti afatgjatë disavjeçar, në bashkëpunim me MEPJ dhe bashkësitë fetare, për promovimin e shembullit unik të bashkëjetesës fetare shqiptare, në trevat shqipfolëse të rajonit.

5) PARASHIKIMI BUXHETOR ME ZËRAT PËRKATËS

Bazuar në ligjin 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, dhe në mbështetje të objektivave të parashtruara, të rezultateve të arritura dhe realizimeve buxhetore gjatë vitit 2024, shuma që i është akorduar KSHK-së është 143,600,000 lekë, e ndarë në zërat specifike ekonomike (sipas tabelave të mëposhtme). Për përdorimin me efikasitet e përgjegjshmëri të këtij fondi, do të vazhdojë të veprojë Grupi i Menaxhimit Strategjik, që do të monitorojë shpenzimet me realizimin e objektivave dhe do të ndërhyjë në zgjidhjen e mangësive që mund të evidencohen. Nëpunësja zbatuese duhet të ndjekë hap pas hapi realizimin e tyre dhe t’i reflektojë ato në pasqyrat periodike të parashikuara me ligj, duke respektuar afatet kohore dhe titullari, në rolin e nëpunësit autorizues duhet të ushtrojë kompetencat e tij, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Nevojat institucionale shtrojnë nevojën e prokurimeve me blerje të vogël dhe komisioni i ngritur për këtë qëllim, të zbatojë rigorozisht të gjitha procedurat ligjore për të siguruar transparencën maksimale. Njëkohësisht, promovimi i bashkëjetesës fetare në nivel ndërkombëtar dhe vijueshmëria e rrjetit bashkëpunues mes homologësh, si pjesë të detyrave ligjore, të shprehura në VKM nr. 459, datë 23.09.1999, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet, pika 2, pragrafi 8, parashtrajnë nevojën e parashikimit të udhëtimeve jashtë vendit (Bashkëngjitur: Tabela e planifikimit të udhëtimeve jashtë vendit për KSHK-në për vitin 2025).

Buxheti i miratuar për vitin 2025 sipas ligjit nr. 115/2024

EMËRTIMI I PROGRAMIT	TOTALI I SHPENZIMEVE KORRENTE (MIJË LEKË)		TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE (MIJË LEKË)	TOTALI I SHPENZIMEVE BUXHETORE (MIJË LEKË)
	PERSONELI	TË TJERA		
	20,025	122,575		
MBËSHTETJE PËR KULTET FETARE	142,600		1,000	143,600

**PARASHIKIMI BUXHETOR SIPAS ZËRAVE EKONOMIKË
PËR VITIN 2025**

Kapitull	Artikull	Emërtimi	Plani vjetor
01	6009999	Shpenzime personeli	20,025,000
01	6029999	Shpenzime te tjera (602, 604, 606,)	122,575,000
01	2310000	Shpenzime kapitale	1,000,000
		TOTALI	143,600,000
Kapitull	Artikull	Emërtimi	Plani vjetor
01	600	Paga Totali	<u>17,340,000</u>
	6001001	Pagat baze	1,512,000
	6001002	Raporte mjeksore	
	6001003	Shtese vjetersie	1,850,400
	6001004	Shtese veshtiresie	
	6001005	Shtese funksioni	13,977,600
	6001008	Shtese page per kulifikim	
	6001013	Shtese page per pune jash orari	

	6001099	Shtese page te tjera	
	600902	Page me kontrate	
	600903	Fondi veçantë	
01	601	Kontrib.sig.shoq.shend. Totali	<u>2,685,000</u>
01	602	Mallra e shërb. tjera. Totali	<u>9,575,000</u>
01	6020	<u>Materiale zyre dhe te pergjithshme</u>	<u>480,000</u>
	60201	Kancelari	120,000
	60202	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	120,000
	60203	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres.	120,000
	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme.	120,000
01	6021	Materiale dhe sherbime speciale	<u>120,000</u>
	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	120,000
01	6022	<u>Shërbime nga te trete</u>	<u>1,930,000</u>
	6022001	Elektriciteti	490,000
	6022002	Uje	350,000
	6022003	Telefon	210,000
	6022004	Posta	50,000
	6022007	Shërbime bankare	10,000
	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	120,000
	6022099	Sherbime te tjera	700,000
01	6023	<u>Shpenzime transporti</u>	<u>1,890,000</u>
	60231	Karburant dhe vaj	1,200,000
	60232	Pjese kembimi, goma dhe bateri	450,000
	60233	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	120,000
	60239	Shpenzime te tjera transporti	120,000
01	6024	<u>Shpenzime udhëtimi</u>	<u>3,955,000</u>
	60240	Udhëtim i brendshem dhe i jashtem	3,955,000
01	6025	<u>Mirëmbajtje të zakonshme</u>	<u>600,000</u>
	60253	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	120,000
	60254	Shpenz.per miremb.rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	120,000
	60255	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike etj.	120,000
	60256	Shpenzime per mirembajtje mjete transporti	120,000
	60258	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	120,000

01	602.6	<u>Shpenzime per qeramarrje</u>	<u>240,000</u>
	602.61	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	120,000
	6026400	Shpenzime per qiramarrje mjetesh transporti	120,000
01	<u>6029</u>	<u>Shpenzime te tjera operative</u>	<u>360,000</u>
	6029001	Shpenz.pritje percjellje	120,000
	6029003	Shpenz gjyqesore	120,000
	6029008	Shpenz.per tatime dhe tax te pag nga institucioni	120,000
01	604	Te tjera Transferta Korrente te Brendshme	<u>113,000,000</u>
	6044099	Te tjera transferta per institucionet jo-fitim prurese (bashkesive fetare)	113,000,000
	6060099	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	
TOTALI SHPENZIMEVE			122,575,000

DETAJIMI I INVESTIMEVE PER VITIN 2025

Kapitull	Artikull	Emërtimi	Plani vjetor
01	231000	Pajijse kompjuterike	<u>1,000,000</u>
TOTALI			<u>1,000,000</u>

REGJISTRI I PROKURIMEVE PUBLIKE TË PARASHIKUARA PËR VITIN 2025

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Lloji i regjistrit të prokurimit	Fondi i përllogaritur	Burimi i Financimit	Vlera	Koha e planifikuar për zhvillimin e procedurës
1	Sherbime per qiramarrje ambientesh	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
2	Sherbime mirembajtje periodike te automjetit	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
3	Sherbime gjyqesore	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
4	Sherbime qiramarrje mjet transporti	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
5	Materiale dhe sherbime speciale	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
6	Sherbime karrotreci	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	25,000	Buxheti i shtetit	25,000	Dhjetor
7	Sherbime pastrimi per zyra	Shërbime	Procedure Prokurimi	208,333	Buxheti i shtetit	208,333	Dhjetor
8	Blerje karburanti	Mallra	Procedure Prokurimi	1,000,000	Buxheti i shtetit	1,000,000	Dhjetor
9	Blerje kancelarie	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
10	Sherbime IT	Shërbime	Procedure Prokurimi	250,000	Buxheti i shtetit	250,000	Dhjetor
11	Sherbime printimi	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
12	Blerje pajisje kompjuterike	Mallra	Procedure Prokurimi	833,333	Buxheti i shtetit	833,333	Dhjetor
13	Sherbime mirembajtje te aparateve, pajisjeve teknike	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor

14	Bileta te transportit ajror nderkombetar	Shërbime	Procedure Prokurimi	800,000	Buxheti i shtetit	800,000	Dhjetor
15	Sherbime larje mjet transporti	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	75,000	Buxheti i shtetit	75,000	Dhjetor
16	Sherbime mirembajtje ndertese	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
17	Blerje materiale zyre dhe te pergjithshme	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
18	Blerje tonerash per printer dhe fotokopje	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
19	Shpenzime per mirembajtjen e rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje, etj.	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
20	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
21	Shpenzime pritje percjellje	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
22	Sherbime mirembajtje pajisje zyre	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor
23	Pjese kembimi, goma dhe bateri	Mallra	Procedure Prokurimi	375,000	Buxheti i shtetit	375,000	Dhjetor
24	Blerje materiale pastrimi	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100,000	Buxheti i shtetit	100,000	Dhjetor

Tabela e planifikimit të udhëtimeve jashtë vendit për KSHK-në për vitin 2025

NR	VENDI PËR KU UDHËTOHET	QËLLIMI	PERIUDHA	NR I PUNONJËSVE	NR I DITËVE
1	Zvicër	Vendosje kontaktesh me komunitetin mysliman shqiptar. Njohje dhe shkëmbim eksperience për krijimin e bazave të një netuorku mes homologësh.	Shkurt	2	3
2	Austri	Vendosje kontaktesh me komunitetin mysliman shqiptar. Njohje dhe shkëmbim eksperience për krijimin e bazave të një netuorku mes homologësh.	Prill\Maj	2	3
3	USA	Takime pune me komunitetin mysliman në SHBA si dhe me klerin e diasporës	Maj	3	6
4	Gjermani	Njohje dhe shkëmbim eksperience për krijimin e bazave të një netuorku mes homologësh	Tetor	3	3
5	Maqedoni	Vazhdimësia e shkëmbimit të përvojave dhe organizimi i aktivitete të përbashkëta	Qershor	2	2
6	Vatikan	Pjesëmarrje në Audiencë me Papën.Takime me Dikasterin e Dialogut Ndërfetar	Tetor ose nëntor	6	2
7	Francë	Njohje dhe shkëmbim i përvojave dhe organizimi i aktivitete të përbashkëta	Qershor	2	2
8	Maltë	Njohje dhe shkëmbim i përvojave dhe organizimi i aktivitete të përbashkëta.	Tetor	2	2

9	Itali	Njohje dhe shkëmbim i përvojave dhe organizimi i aktivitete të përbashkëta. Takime me komunitetin arbëresh.	Dhjetor	2	2
---	-------	---	---------	---	---